# ZEJTAR





Gazetën e boton Oda e zejtarëve te R.së Maqedonisë dhe Oda e zejtarëve Koblenc

Zanati e ardhmja jonë

Numur 16 | Dhjetor 2009 | www.zkomora.mk


HWK

OZRM







### OZRM me përfaqësi në Qendrën e qytetit të Shkupit

Që nga qershori me ndihmën financiare të partnerit gjerman Odës zejtare Koblenc, Oda e zejtare e R.së Maqedonisë ka përfaqësi në rrugën Marshall Tito 47/1-2 në qendër të qytetit...

Më gjerë në faqen 2

### Presidenti Gjorgje Ivanov vizitoi bazarin e zejtarëve në Dojran

Dojran, 29 nëntor-Më shumë se 20 zejtarë individualë nga Shkupi, Gjevgjelia, Bogdanci, Negotina, Strumica, Dojrani, Berova dhe nga Bullgaria morrën pjesë në bazarin zejtar që e oganizoi Komuna e Dojranit së bashku me Odën e Zejtarëve Koblenc e cila është në partneritet me Odën e Zejtarëve të R. së Maqedonisë...

Më gjerë në faqen 3

### Gruaja sipërmarrëse

Në bashkëpunim me Odën e zejtarëve Koblenc dhe zyrës Ballkanike për zhvillim të ekonomisë së vogël dhe zejtarisë, gratë sipërmarrëse nga fusha e zejtarisë formuan lidhje të grave ballkanike për zejtarinë...

Më gjerë në faqen 5



Të nderuar zejtarë,

Zejtaria është një faktor i rëndësishëm për zhvillimin e jetës ekonomike, politike dhe sociale të një vendi.
Tradita e zejtarisë në Maqedoni është zhvilluar në një ambient të begatë dhe të pasur të historisë sonë.
Shoqërimi në sektorë dhe oda për arsye të përmbajtjes dhe forcimit të interesave të zejtarëve ka rrënjët e tij që nga e kaluara e hershme.
OZRM si Odë që është përbërë nga oda të tjera është formuar në vitin 2004. Në Odën tonë antarësojnë 14 Oda rajonale zejtare me qëllim përparimin e zejtarisë, përmirësimin e cilësisë së produkteve dhe shërbimeve zejtare, si dhe koordinimin dhe përfaqësimin e interesave të përbashkëta.
Me qëllim që zejtaria ta fitojë vendin e merituar në shoqëri e domosdoshme është mbajtja e dialogut politik me të cilin do të mundësohet vendosja e kushteve kornizë për zhvillim dhe përparim të ekonomisë së vogël dhe zejtarisë. Për atë qëllim ne i përfaqësojmë interesat e tyre para Qeverisë dhe Kuvendit të R. së Maqedonisë.
Duke marrë parasysh se një nga qëllimet tona është promovimi dhe ruajtja e interesave të zejtarisë, vëmëndje të madhe i kushtuam edhe marëdhënieve me publikun, sepse vetëm me një komunikim cilësor me gjithe rëndësine e brendëshme dhe të jashtme të publikut mund të arrijmë respektin e dyanshëm.
Synimi ynë është që nëpërmjet kësaj gazete zyrtare anëtarët tanë të fitojnë informacione dhe këshilla të vlefshme në lidhje me punën e tyre.
Njëkohësisht dua T`ju falenderoj për bashkëpunimin e deritanishëm për vitin e kaluar 2009 të gjithë atyre që dhanë kontributin e tyre për zhvillimin e Odës zejtare në R. e Maqedonisë dhe zejtarisë në përgjithësi, si dhe T`ju urojmë të gjithëve shëndet të mbarë, suksese në punë dhe vazhdim të bashkëpunimit tonë në vitin 2010.

Kryetar I OZRM-së
Gligor Cvetkov

## ODA E ZEJTARËVE TË R. SË MAQEDONISË

Oda e zejtarëve të R.së Maqedonisë është formuar në bazë të ligjit të kryerjes së punës zejtare me qëllim: Përparim të zejtarisë, Përmirësim të cilësisë së prodhimeve dhe shërbimeve të zejtarëve si dhe, për shkak të përshtatjes dhe përfaqësimit të interesave të përbashkëta. Në Odën e zejtarëve të Republikës së Maqedonisë e cila është e formuar në vitin 2004 antarësojnë 14 Oda rajonale të zejtarisë në të cilën anëtarë mund të jenë zejtarë si dhe kryes të punës zejtare e të tjerë persona juridikë, të cilët me aktivitetet e tyre bëjnë të mundur përparimin dhe zhvillimin e zejtarisë. Zejtaria për ta fituar vendin e duhur në shoqëri duhet ta udhëheq një qëllim konstruktiv Dialogu politik me të cilën bëhet e mundur vënia e kushteve kornizë për zhvillim dhe përparim të ekonomisë dhe zejtarisë së vogël .I përfaqësojmë interesat e gjithanshme të zejtarisë para Parlamentit dhe Qeverisë si dhe institucioneve të tjera shtetërore. Oda e zejtarëve e R. së Maqedonisë kujdeset për :

- Realizim të interesave të përbashkëta shoqërore, ekonomike sociale të zejtarëve;
- Përfaqësim të interesit të anëtarëve të vet para organeve kopetente shtetërore dhe institucioneve (gjatë formimit të rregullores ligjore) në formimin e rregullores ligjore.
- Dorëzon tek organet kopetente të R .Maqedonisë propzime dhe mendime për vendime të caktuara ligjore nga fusha e zejtarisë.
- Zhvillim dhe përparim të zejtarisë në kufijtë e veprimtarisë së lirë dhe ligjet e ekonomisë së tregut.
- Vënia e një sistemi të vetëm informativ për informacione biznesi dhe të tj. të nevojshme për zhvillimin e zejtarisë në R. e Maqedonisë;
- Vënia e një sistemi informativ për biznes dhe informacione të domosdoshme për zhvillimin e zejtarisë në R.e Maqedonisë.
- Nxitja dhe zhvillimi i bashkëpunimit me asociacione të huaja të njëjta ose të ngjashme, me një synim të caktuar, promovimin nacional të zejtarisë nëpër panaire, ekspozita dhe manifestime të ngjashme në vend dhe botë;
- Sjell programe për trajnim, rikualifikim në qendrat e trajnimit;
- Përputhja e programeve për kontroll të aftësive profesionale si dhe programeve për dhënien e provimit mjeshtëror.
- Shkruan formën dhe brendinë e çertifikatës për marrjen e provimit mjeshtëror.
- Zgjidhje e konflikteve midis anëtarëve të vet.





## Oda e zejtarëve të R.së Maqedonisë (OZRM) me përfaqësi në Qendrën e Qytetit të Shkupit

Që nga qershori me ndihmën financiare të partnerit gjerman Odës zejtare Koblenc, Oda e zejtare e R.së Maqedonisë ka përfaqësi në rrugën “Marshall Tito” 47/1-2 në qendër të qytetit. Në hapjen solemne të Odës mermin pjesë udhëheqësit më të lartë të Odës gjermane, përfaqësues të ambasadës Gjermane, përfaqësues të Parlamentit të R.së Maqedonisë, të Ministrive miq nga vendet ballkanike si dhe organizata zejtare ndërkombëtare.Të pranishmit i përshendeti Zëvendës. Ministri i ekonomisë z. Metodij Haxhi-Vaskov i cili në fjalën e tij theksoi se përparimi i ekonomisë Maqedonase do të jetë një nga prioritetet kryesore të qeverisë. Për këtë Qeveria e R. së Maqedonisë është e vendosur të vazhdojë me të gjitha aktivitetet dhe masat e saj për mbështetjen dhe zhvillimin e EVM (ekonomisë së vogël dhe të mesme ) dhe kjo nëpërmjet promovimeve dhe zhvillimeve të zejtarisë, lehtësimin e procedurave financiare si dhe për forcimin e infrastrukturës, institucionalizimin e ndërmarrjeve mikro të vogla dhe të mesme. Gjithashtu zëvendës ministri i ekonomisë falemderoi organizatorët dhe veçanarisht falenderoi Odën e zejtarëve Koblenc, të cilat kanë dhënë një mbështetje të veçantë dhe kanë ndarë përvojën e tyre me Odën e Maqednisë. Duke uruar punë të mbarë dhe të frutshme Haxhi-Vaskov shprehu besim që ky projekt do të ketë një zhvillim më të gjerë rajonal dhe njëkohësisht i motivoi zejtarët të marrin pjesë aktive në jetën ekonomike të R.së Maqedonisë.

**Oda zejtare e R.së Maqedonisë**
Rruga Marshall Tito nr.47/1-2,1000 Shkup, R.M.

Tel/fax: +389(0)23213-308
+389(0)23118-657
e-mail contact@zkomora.com.mk; info@zkomora.mk
web:www.zkomora.mk

OZRM
ODA E ZEJTARËVE
TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

## Presidenti Gjorgje Ivanov vizitoi bazarin Rajonal të zejtarëve në Dojran



**Dojran, 29 nëntor** - Më shumë se 20 zejtarë individualë nga Shkupi, Gjevgjelia, Bogdanci, Negotina, Strumica, Dojrani, Berova dhe nga Bullgaria morrën pjesë në bazarin zejtar që e oganizoi Komuna e Dojranit së bashku me Odën e zejtarëve Koblenc e cila është në partneritet me Odën e Zejtarëve të R.së Maqedonisë.

Qëllimi i projektit është vënia në dukje e rëndësisë së ruajtjes së prodhimeve zejtare të vendit, të cilët përfaqësojnë një segment të rëndësishëm nga tradita dhe kultura e Maqedonisë.

Takimi i parë rajonal i zejtarëve në jug të Maqedonisë e hapi kryetari i komunës së Dojranit, z.Gligor Çabulev, ndërsa për rëndësinë në tërë rajonin foli menaxheri i projektit, z.nj. Olivija Shterjova, dhe kryetari i Odës së zejtarëve të R.së Maqedonisë, z.Gligor Cvetkov.

Në bazarin rajonal të zejtarëve ishte i pranishëm dhe Presidenti i R. së Maqedonisë Gjorgje Ivanov i cili me praninë e tij theksoi rëndësinë e punimeve tradicionale me dorë dhe zanateve.

Vitrinat ishin të ekspozuara në sallën e hotelit "Istatov", ku dominonin pëlhura, të thurura dhe prodhime të endura, sende dekorative dhe të gdhendura, stoli, të punuara prej druri dhe bakri. Manifestimi kishte dhe karakter shitës.



## Bazar festiv për artizanate dhe zanate

Nga periudha 04.deri 06.dhjetor. 2009 rreth 30 zejtarë nga Shkupi, Kavadarci, Kumanova, Probishtipi, Mnastiri dhe Vinica morrën pjesë në bazarin festiv për artizanate tradicionale dhe shtëpiake në Odën e zejtarëve në çarshinë e vjetër të Shkupit. Organizatorë të këtij manifestimi ishin Oda e zejtarëve Shkup së bashku me partnerin e saj nga Gjermania Oda e zejtarëve Koblenc.

Të mërkurën më 03.dhjetor bazari festiv u hap në mënyrë solemne me koktel në të cilin merrte pjesë z.nj.Liljana Popovska, deputete në Kuvendin e Maqedonisë, përfaqësues të Qytetit të Shkupit si dhe të institucioneve të tjera të R.së Maqedonisë. Manifestacionin e hapi z.nj. Snezhana Denkovska drejtor ekzekutiv i Odës së zejtarëve të Shkupit , bashkë me z.nj. Olivija Shterjova menaxher i projektit të Odë së zejtarëve Koblenc në Maqedoni. Hapja solemne u përcoll nga televizioni TELMA në programin e vet.

Në bazarin festiv Oda e zejtarëve të Shkupit së bashku me partnerin e saj Odën e zejtarëve Koblenc mundohen të promovojnë vlerat tradicionale dhe kulturore në territorin e R.së Maqedonisë të shprehura nëpërmjet punës së dorës (artizanale), kulturore vendore.

Vitrinat e ekspozuara ishin sistemuar dhe ekspozuar brenda sallonit të Odës së zejtarëve, ndërsa tek këto dominonin pëlhura, produkte (prodhime) të thurura dhe të qëndisura, objekte zbukurimi të gdhendura, stoli, punime prej druri dhe bakri. Shumë vizitorë kënaqeshin në ambientin e përkryer të bazarit festiv.

Me përvojën e mirë dhe kënaqësinë të cilën e shprehën të gjithë pjesmarrësit vitin e ardhshëm partnerët e Odës së Shkupit me ata të Gjermanisë përkatësisht me ata të Koblencit planifikojnë të mbahet një bazar i tillë.








Karlsrue Gjermani
21.-23. prill 2010-01-29
www.resale-germany.com

**Vizitë e organizuar në panairin për pajisje të përdorura në Karlsrue, Gjermani nga 21 deri 23 prill të vitit 2010**

## Panairi i 16-të për makineri të përdorura

Më shumë se 1000 makineri të përdorura mund të shihen dhe të blihen. Ky është panairi më i madh botëror për pajisje të përdorura në të cilin ka më shumë se sa 500 pjesmarrës nga 28 vende si dhe reth 10.000 vizitorë nga e gjithë bota. Ju lutemi në qoftë se jeni të interesuar të vizitoni panairin dhe të jeni pjesë e grupit të organizuar të zejtarëve duhet të kontaktoni në adresën e mëposhtme:

**Oda e zejtarëve të R. së Maqedonisë dhe Oda e zejtarëve Koblenc**
Rruga Marshall Tito 47/1-2; 1000 Shkup, Maqedoni
Tel. 02/3213-308; 311-865
E-mail:contact@zkomora.com.mk

**Tek ne keni mundësi të fitoni bileta hyrjeje me çmim më të ulët!**
Në panair mund të gjeni makineri nga 23 fusha.

OZRM
ODA E ZEJTARËVE
TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

## SHPALLJA E MJESHTËRVË TE PARË ZEJTARË

Ftohen të gjithë **ZJETARËT** nga territori i **Republikës së Maqedonisë** të cilët i plotësojnë kushtet e parapara në Rregulloren për shpalljen e mjeshtërve të parë të paraqiten për trajnim të cilin do ta udhëheq Oda e Zejtarëve e R. së Maqedonisë në bashkëpunim me Odën e Zejtarëve Koblenc -R. e Gjermanisë ,që të pajisen me **DIPLOMA PËR DHËNIEN E PROVIMIT PËR MJESHTËR .**

Kushtet për pjesmarrje në trajnim për shpalljen e mjeshtërve të parë janë :

- së paku të jetë 35 vjeç
- së paku 15 vjet punë të pavarur
- së paku të ketë shkollë të mesme përkatëse tre vjet ose katër vjet (në përjashtim për zanate të vjetra dhe zanate që janë në zhdukje e sipër nevojitet vetëm arsimi fillor).

Dokumentet e nevojshme për paraqitje janë:

- Letërnjoftimi
- Dëshmi për arsim përkatës
- Vërtetim për regjistrim në regjistrin tregëtar ose të Zejtarëve

Trajnimi do të udhëhiqet nga trajnues kompetent nga fusha e punës pedagogjike, ekonomike dhe juridike.

Trajnimi do të zgjat 6 ditë (ne dy fundjava -e premte ,e shtunë dhe e dielë) dhe do të realizohet në katër qytete në Maqedoni.

**ZEJTARËT** e interesuar dhe **KRYESIT E KËSAJ VEPRIMTARIE** mund të paraqiten për trajnim për shpalljen e mjeshtërve të parë duke plotësuar fletëparaqitjen.

Për të gjitha informatat drejtohuni në:

**ODA E ZEJTARËVE TE R.M**
Marshal Tito,47/1-2, 1000 Shkup, Tel: +389(0)2/3213-308,
**e-mail.:contact@zkomora.com.mk**

ose në kontaktet e mëposhtme në **ODAT RAJONALE:**

Tel.: **Shkup** 02/3237-850, **Kumanovë** 031/424-227, **Dibër** 046/838-000, **Manastir** 047/232-880, **Ohër** 046/260-202, **Strumicë** 034/323-913, **Gjevgjeli** 034/212-930, **Vinicë** 033/361-110, **Shtip** 032/522-602, **Veles** 043/234-593, **Prilep** 048/414-519, **Resnjë** 047/452-550.




## HACCP SISTEMI NGA 01 JANARI HYN NË FUQI

Me ligjin për sigurim të ushqimit, produkteve dhe materijaleve të cilët bien në kontakt me ushqimin hyrja në fuqi e HACCP është një obligim ligjor për të gjithë ata që merren me ushqimin.
Meqënse kërkesat për operatorët për ushqimin krijojnë mbingarkesë dhe kërkojnë mjete finansiare shtesë për zejtarët dhe ushtruesit e veprimtarive zejtare, ne antarët e Odës organizojmë dy ligjerata (seminare) të cilat do të realizohen në muajin janar.
Tema e leksioneve është: Si të realizohet HACCP në mënyrën më adekvate? Ligjërues është Aleksandra Markovska e cila është tutor përkthyes internacional i akredituar për trajnimet e HACCP.

Për vendin dhe kohën e mbajtjes së ligjeratave, informohuni tek këto kontakte:
**Marijana Jovanovska**, tel.02/3213-308 ose në e-mail: contact@zkomora.com.mk.


**FOOD CONSULTING**
**Имплементација на HACCP, HALAL, GLOBALGAP, ISO 9001, 22000, 14001**
**Подготовка на апликации за ИПАРД**

# ODA E ZEJTARËVE KOBLENC



**Aktivitete të realizuara në bashkëpunim me Odën e zejtarëve Koblenc dhe Kancelarisë Ballkanike për zejtari dhe ekonomi të vogël**

Oda e zejtarëve Koblenc që nga viti 2008 realizon projekt partneriteti për mbështetjen e zejtarisë në Maqedoni. Ka dy partnerë dhe pikërisht Odën e zejtarëve të R. së Maqedonisë si dhe Odën e zejtarëve të Shkupit. Projekti është finansuar nga ana e Ministrisë së ekonomisë dhe zhvillimit nëpërmjet fondacionit SEQUA dhe do zgjasë deri në fund të vitit 2011.

Qëllimet kryesore të partneritetit janë:

**"Zejtaria në Maqedoni gjithnjë e më shumë sjell dhe ka ndikim në zhvillimin ekonomik dhe social të vendit".**

Qëllimi i projektit definohet si:

**"Zejtarët në Maqedoni përfitojnë nga përmirësimi i vetadministrimit në fushat: Përfaqësim të interesave; afrim të shërbimeve dhe të arsimit profesional."**


**Ost-West GmbH**
**Oda zejtare Koblenc**

Rruga ."Marshall Tito" nr.47/1-2 1000 Shkup
Tel./fax:+389(0)23213-308
Tel./fax:+389(0)23118-657

email: olivija.tasic@zkomora.com.mk
www.zkomora.mk
www.hwk-koblenz.de
www.balkan-handwerk.org


### Dialog ekonomiko-politik
### Dhjetor 2009, Koblenc

Nga data 8 deri 9 dhjetor u takuan udhëheqësit e organizatave të zejtarëve të ekonomisë së vogël dhe të mesme të Shqipërisë, Bullgarisë, Bosnjë Hercegovinës, Sërbisë, Malit të Zi, Kosovës, Kroacisë, R. së Moldavisë, Rumanisë dhe R.së Maqedonisë që së bashku me kolegët gjermanë të bisedojnë për arritjet më të reja si dhe ambicjet në fushën e zejtarisë në ekonominë e vogël dhe të mesme.

Në kuadër të projektit i cili është udhëhequr nga ana e kancelarisë Ballkanike për ekonominë e vogël dhe të mesme dhe ku mernin pjesë vendet e Europës juglindore, Maqedonia përfaqësohej nga Kryetari i Odës së zejtarëve z.Gligor Cvetkov si dhe përfaqësues të Odave rajonale të Shkupit, Kumanovës, Shtipit, Gjevgjelisë dhe Resnjës. Gjithashtu nga R. e Maqedonisë merrte pjesë dhe Liljana Popovska deputete në parlamentin e R. së Maqedonisë.

Si temë e veçantë e bisedimit ishte politika zbatuese e Europës për zejtarinë, ekonominë e vogël dhe të mesme si dhe situata aktuale ekonomike.Në një kuadër të veçantë në sallën solemne të komunës në Koblenc u prezantuan arritjet në bashkëpunimin e jashtëm të rajonit Rajnland-Pfalc si dhe u shqyrtuan mundësitë për bashkëpunim të mëtejshëm. Në ditën e dytë vazhdoi konferenca në një qendër moderne të kompletuar ku u prezantua afrimi i shërbimeve nga ana e Odës së zejtarëve Koblenc dhe kjo la përshtypje, ide dhe inspirata tek partnerët. Në këtë ditë u shqyrtuan tema nga fusha e aftësisë profesionale si dhe shërbimet dhe mundësitë që afrohen nga kjo fushë nëpërmjet bashkëpunimit për zhvillim. Nga viti 2008 kancelaria Ballkanike për ekonomi të vogël e cila është përbërë nga 32 organizata zejtare, ekonomi të vogla dhe të mesme të cilat janë pjesë të vendeve të Europës juglindore udhëheqin projektin "Bashkëpunimi ekonomik midis Rajnland-Pfalc dhe Europës juglindore". Siç edhe flet vet emri i projektit nga ana gjermane janë përfshirë shumë organizata të cilat e zmadhojnë dimencionin e këtij bashkëpunimi.





## GRUAJA SIPËRMARRËSE

Në bashkëpunim me Odën e zejtarëve Koblenc dhe zyrës Ballkanike për zhvillim të ekonomisë së vogël dhe zejtarisë, gratë sipërmarrëse nga fusha e zejtarisë formuan lidhje të grave ballkanike për zejtarinë. Idea konsiston në faktin të ofrohet përfaqësim i plotë i interesave të grave të cilat janë të angazhuara në zejtari, si dhe këmbim të eksperiencës dhe të organizimeve nëpërmjet themelimit dhe veprimtarisë efektive të një shoqate të pavarur.

Kjo shoqatë është formuar në 03.shkurt të 2009 në Durrës të Shqipërisë dhe në konferencën e saj në prill të vitit 2009 në Pllovdiv u miratua statusi i shoqatës dhe solli deklaratë Politike.

Qëllimi i kësaj shoqate në të ardhmen është që gratë të ndikojnë në politikë dhe ekonomi në marëdhëniet midis shteteve me qëllim krijimin e kushteve optimale që gratë nga fusha e zejtarisë të japin kontribut dhe zhvillim të firmave të tyre, si dhe zhvillim të shteteve të tyre. Aktivitetet përfshijnë tre fusha: Udhëheqje të dialogut politik për përfaqësim më të mirë të interesave specifike si dhe të kërkesave të grave nga ana e zejtarisë; Afrim të programve shkollore të larmishme dhe programe trajnuese për gratë si dhe krijimin e kontakteve ndërkombëtare dhe mundësisë për këmbim të përfaqësive të grave dhe të interesave të njëjta.

Në kuadër të qëllimeve të përcaktuara në Ahrveiler, Gjermani nga 05.-06. tetor u mbajt takim pune të lidhjes Ballkanike me temë: "Kultura sipërmarrëse". Ishin shqyrtuar dhe aspekte të zhvillimit ekipor, motivi dhe stilet e përparimit; aspekte multikulturore të menaxhimit, faktorët për sukses si dhe u bë vizitë tek firmat e grave-sipërmarrëse. Në takim merrnin pjesë dhe përfaqësuese nga Qendra e Europës së mesme dhe kopetente; Shoqata gjermane e sipërmarrësve; shoqata e bashkuar e sipërmarrësve në zejtari (nga Gjermania); Ministria e ekonomisë dhe transporteve, bujqësisë të krahinës Rajnland-Pfalc, të cilët i përcollën dhe i shkëmbyen përvojat dhe njohuritë e tyre të fituara në veprimtarinë aktive shumëvjeçare në fushën e ekonomisë së vogël dhe zejtarisë. Takime të tilla dhe të ngjashme të frymëzuara nga interesi i madh i grave do të vazhdojnë edhe në të ardhmen.



**Gratë dinë dhe realizojnë.**

# ODA E ZEJTARËVE KOBLENC

## SEMINAR PROFESIONAL PËR PUNONJËSIT E KOZMETIKËS

Si pjesë e projektit Pilot për implementimin e Ligjit për arsimin profesional dhe trajnimin më datën 12.12.2009 (e shtunë) dhe më 13.12.2009 (e diel) në Odën e zejtarëve Shkup u mbajt seminar adekuat për punonjesit e kozmetikës të cilin e udhëhiqte z.nj. Jasmina Ivanova nga Bullgaria. Z.nj. Ivanova është Kryetar i Odës së zejtarëve Vraca, si dhe Nënkryetar i Odës së zejtarëve të Republikës së Bullgarisë. Në ditën e parë të seminarit pjesmarrës ishin nxënësit-nga shkolla e mesme profesionale "Dimitar Vllahov" Shkup të cilët dëgjonin leksione për trajtimin e lëkurës, analizën si dhe vlerësimin e preparateve moderne kozmetike për trajtimin e lëkurës.

Në ditën e dytë të seminarit u prezantuan temat e mëposhtme:

**1.** Masazhë dhe drenazh për sëmundjet venoze.

**2.** Masazhë dhe drenazhë kur ka probleme cirkulative të fytyrës.

**3.** Terapi antistres.

**4.** Roli i hormoneve në tipe të ndryshme lëkure.

Në seminar morrën pjesë përfaqësues të kozmetikës nga Shkupi, Ohri, Shtipi dhe Kumanova. Aktualiteti i temave tërhoqi një vëmendje të madhe si dhe interes për mbajtjen e një seminari tjetër i cili mund të jetë në formë të trajnimit modular.







### Shkëmbim të praktikantëve, nxënës dhe sipërmarrës të rinj midis shteteve partnere dhe Gjermanisë

Përfaqësuesit kopetentë të organizatave partnere nga Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Maqedonia, Moldavia, Sërbia, Rumania, Kosova, Mali i Zi dhe Gjermania më 29.09.2009 në Koblenc e mbajtën takimin e dytë të punës midis shteteve të Europës Juglindore, me temë: "Shkëmbim praktikantësh, nxënës dhe sipërmarrës të rinj midis shteteve partnere dhe Gjermanisë". Themeli i këtij shkëmbimi është vënë në Pllovdiv në prill të vitit 2009.

Qëllimi i këtij shkëmbimi është të tejkalohen vështirësitë me të cilat hasen të rinjtë në vendet e tyre dhe ato janë probleme nga fusha e arsimit profesional, probleme të cilat dalin në pah për shkak të mungesës së edukimit praktik të nxënësve në kushte reale si dhe kërkesës për egzistencën e një trajnimi profesional në kuadr të një rregullore moderne ligjore. Nëpërmjet pjesmarrësve përfaqësues nga qendrat e trajnimit organizatat dhe institucionet do të sigurojnë një model funksional për bashkëpunim në fushën e trajnimit profesional. Në takimin e punës mbasi u prezantua përvoja e Odës së Koblencit në këmbimin e praktikantëve, si dhe në diskutimin e hapur, u përcaktua kuadri i këmbimit më saktë mosha e praktikantëve, viti i arsimimit, madhësia e grupeve, kohëzgjatja e praktikës, llogaritja e shpenzimeve dhe dokumentacioni i duhur.

Kërkesa dhe oferta për këmbim të praktikantëve do të publikohen në kuadrin e bursës të praktikantëve e shprehur në faqet e internetit të projektit ekonomik , bashkëpunim midis vendeve të Europës Juglindore dhe Rajnland-Pfalc si dhe në faqen e kancelarisë Ballkanike për zhvillim të ekonomisë së vogël dhe zejtarisë. Shkëmbimi i parë ishte i parashikuar të realizohej midis Maqedonisë dhe Sërbisë, por për fat të keq për shkak të ndërprerjes së mësimdhënies në Sërbi shkëmbimi u shty për në vitin 2010. Ky projekt u prit me interes të madh nga pjesmarrësit sidomos nga nxënësit që në fakt janë pjesë e të njëjtit projekt.

# ODA RAJONALE E ZEJTARËVE DIBËR

Oda Regjionale e Zejtarëve Dibër
Regionalna Zanaetciska Komora Debar

Oda rajonale e zejtarëve Dibër është formuar në vitin 2005 dhe mbulon komunat: Dibër, Qendër Zhupa, Mavrovë dhe Rostushë. Përfaqësia e Odës është në rrugën 8 shtator bb në Dibër. Kryetari i ORZ Dibër është z.Mexhit Erebara-mjeshtër argjendar, udhëheqës ekzekutiv z.Fisnik Saraçi.

ORZ Dibër afron shërbimrt e mëposhtme:

- Sistem njësportelsh për regjistrimin e veprimtarisë zejtare (Vendim për regjistrim në regjistrin e zejtarëve, numur tatimi, numur personal, llogari rrjedhëse, vulë si dhe formularet M1/M2,M,T.U);
- Vendim për përputhjen e veprimtarisë zejtare;
- Vendim për mbylljen e veprimtarisë, ndërrim si dhe mbydhjen e përkohëshme;
- Miratim për ushtruesit e veprimtarisë zejtare;
- Shërbime kontabiliteti dhe juridike;
- Marrëveshje për çirak;
- Shërbime këshilluese dhe informative;
- Plane biznesi dhe investimesh;
- Implementimi i sistemit HACCP, HALAL, ISO standardet e tj.;
- Përgatitje të dokumentacionit për IPA fondet dhe IPARD programet;
- Elaborat ekologjik;
- ORZ Dibër në Partneritet me "Odën zejtare Koblenc" R. e Gjermanisë në vitin 2008 dhe 2009 organizuan shpalljen e mjeshtërve të parë nga rajoni i Dibrës, Qendër Zhupa, dhe Rostusha. ORZ Dibër gjithashtu në bashkëpunim me shtëpinë "FOOD KONSALTING" nga Shkupi realizuan imlementimin HACCP sistemi për zejtarët nga komuna e Dibrës, Qendër Zhupa, Mavrova dhe Rostusha.

Në mbledhjen e Këshillit dejtues të OZRM-së të datës 02.12.2009 antari i ORZ-së Dibër z.Shkëlqim Agolli është zgjedhur në funksionin nënkryetar i ORZM-së. Gjithashtu z.Shkëlqim Agolli morri pjesë në vizitën e mjeshtrëve parukierë nga Maqedonia në Koblenc të R. së Gjermanisë.

ORZ Dibër i informon të gjithë zejtarët dhe ushtruesit e veprimtarisë zejtare se mund të paraqiten në Odën e zejtarëve për të dhënë provimin e mjeshtrit, gjithashtu i informon të gjithë nxënësit (çirakët) se ata mund të paraqiten në Odën e zejtarëve për dhënien e provimit për aftësi profesionale. Shoqata e qytetarëve Rinitolerente Dibër në bashkëpunim me ORZ Dibër në vitin 2010 do të fillojnë realizimin e projektit "Zanat info qendër"i financuar dhe i mbështetur nga Qeveria e R.së Maqedonisë.

ORZ Dibër vend ku tradita vazhdon!!



## ODA RAJONALE E ZEJTARËVE SHTIP



### DARKË ZEJTARE PËR TË TRETËN HERË NË SHTIP

Edhe këtë vit për herë të tretë Oda rajonale e zejtarëve Shkup organizon Darkë zejtare e cila do të mbahet më 27 dhjetor në restorantin "Mall Odmor" me fillim në orën 19.

Të ftuar janë përfaqësues të pushtetit vendor, zejtarë, ushtrues të veprimtarisë zejtare, partnerë dhe miq të zejtarisë. Kënaqësi e madhe është të urojmë në emër të zejtarëve si dhe për zhvillimin e zejtarisë. Të gjithë të interesuarit të lajmërohen në Odën zejtare Shtip në kontaktet e mëposhtme: 032/ 522-602, e-mail: rzk_stip@yahoo.com.



### Instalimi i programit softer
## Evidentimi elektronik i regjistrit të zejtarëve

Në kuadrin e projektit për bashkëpunim me Odën zejtare Koblenc, është përpunuar program për regjistrim të zejtarëve, i cili si shërbim i ofrohet nga ana e Odës zejtare. Në Shtip në Hotelin Oaza në 28. dhe 29. nëntor u mbajt trajnim të personave kopetentë të odave rajonale zejtare për mbajtje më efikase të regjistrit. U diskutua për përmirësim të programit, dhe si ishte realizuar instalimi i programit kompjuterik në oda rajonale të veçanta.

Për herë të parë ishte përpunuar dhe verzioni në gjuhën shqipe, d.m.th. shqip-maqedonisht dhe e njëjta u instalua me sukses.

Vetë ngjarja u ndoq nga televizioni lokal IRIS.

Me ndihmë të këtij trajnimi u hodhën themelet për përmirësim të aftësive dhe njohurive gjatë punës me programe kompjuterike. Qëllimi i këtij trajnimi është që nëpërmjet përmirësimit të kompetencave të të punësuarve në Odat rajonale të përmirësoht dhe oferta e shërbimeve që çdo odë i ofron anëtarëve të saj.





## ODA RAJONALE E ZEJTARËVE GJEVGJELI

Oda rajonale e zejtarëve Gjevgjeli si Odë është formuar në dhjetor të vitit 2004. I përfshin komunat Gjevgjeli, Vallandovë, Dojran dhe Bogdanci.

Si shoqatë e zejtarëve deri në vitin 2004 gjithsej ishin regjistruar 87 zejtarë.

Me kalimin nga shoqatë në Odë rajonale të zejtarëve numri i tyre u rrit në 176, nga profile të ndryshme.

ORZ Gjevgjeli në këtë moment kryen shërbime për regjistrimin e punës zejtare, ofron këshilla juridike, organizon seminare sipas kërkesave të zejtarëve, informon për gjendjen e zejtarisë nëprmjet mediumeve dhe i përfaqëson interesat e zejtarëve para institucioneve shtetërore. Këtë që e ofrojmë sot nuk është e mjaftueshme që të funksionojnë zejtarët në mënyrë të përkryer, por në të ardhmen Oda do mundohet të sigurojë këshillime dhe ndihmë teknike të çdo lloji.

Do përpiqemi të vendosim bashkëpunim me pushtetin vendor në të katër komunat me qëllim që të fitojmë përkrahje (ndihmë) materiale dhe morale nga të njëjtat.

Shpresojmë se në të ardhmen numuri i zejtarëve do të rritet dhe zejtaria do ta fitojë vendin e duhur në ekonomi.

Udhëheqja e ORZ-së Gjevgjeli përbëhet nga z.Tomislav Ristov, Kryetar, si dhe antar i Këshillit drejtues të ORZ-së z.nj. Marija Gaceva.

Z.nj. Marija Gaceva në dhjetor të vitit 2009 morri pjesë si antarë i Këshillit drejtues të Odës së zejtarëve të R.M. në konferencën Politike në Koblenc, Gjermani. Z.nj Gaceva kishte mundësi të vizitonte Odën e zejtarëve Koblenc, të diskutojë për mundësitë dhe prespektivat e zejtarisë dhe ekonomisë së vogël në kuadër të bashkëpunimit rajonal në nivel ballkanik dhe europian.

## Detyrim i zejtarëve dhe ushtruesve të punës zejtare

Në bazë të ligjit për sigurim të shëndetit gjatë punës, gazeta zyrtare e R.M. 92/07, zejtarët dhe ushtruesit e punës zejtare (TP dhe Td) kanë për detyrë të realizojnë:

-kontroll sistematik për vetvete si dhe për të punësuarit dhe trajnim të një të punësuari deri 20 të punësuar .

Për realizim me sukses të kontrolleve sistematike Oda e zejtarëve kujdeset qe këto kontrolle të kenë sukses.

Për informacione më të hollësishme si dhe për koston e të njëjtit duhet të informoheni tek zyra Rajonale e zejtarëve tek e cila jeni antarë.



# ODA RAJONALE E ZEJTARËVE KUMANOVË

## Në Kumanovë janë paraqitur 185 kërkesa për tatim paushal të zejtarëve

Në bazë të nenit 31 nga Ligji për tatimin personal të shpenzimeve (gazeta zyrtare e R.M. nr.80/93.....160/07) i tatuari i cili në rrethana të caktuara nuk është në gjendje ti mbaj regjistrat e punës në mënyrë të konsiderueshme vështirëson kryerjen e veprimtarisë, ka të drejtë të paguaj tatimin personal të veprimtarisë sipas një ligji paushal të të ardhurave.

Për pagesë paushale të shpenzimeve vendos Drejtoria e të ardhurave Publike dhe çdo zejtar i pavarur ka për obligim të paraqesë kërkesë tek organi kopetent përkatësisht tek Drejtoria e të ardhurave publike jo më vonë se 31 dhjetor i vitit. Për shfrytëzim të kësaj lehtësie ligjore nga politika tatimore është e domosdoshme përcaktimi i kushteve të ambientit tregëtar, mobilimin e ambientit tregëtar, numurin e të punësuarve si dhe antarët e familjes të cilat janë të angazhuar në punë, si dhe kushtet tregëtare në të cilët realizohet veprimtaria, aftësia dhe mosha e të punësuarit, madhësia dhe të ardhurat neto të të punësuarit (zejtarit) i cili në kushte të njëjta ose të përafërta kryen veprimtari të njëjtë ose të përafërt si dhe kushte të tjera të cilat ndiokojnë në realizimin e fitimit.

Detyrimi për paraqitjen e kërkesës për pagesë paushale, në bazë të sistemit njësportelsh në këtë rast i përket Odave rajonale të zejtarisë.

Oda rajonale e Kumanovës më 29 nëntor ka paraqitur gjithsej 185 kërkesa të tilla në Drejtorinë e të ardhurave publike Shtip. Praktika e deritanishme për përcaktimin e pagesave paushale ishte punë zyre pa dalë në terenin konkret dhe që këtej del se në vitin 2009 zejtarët e tatuar janë në një numur minimal. Nuk është e drejtë që të vazhdohet me këtë praktikë mbasi në qoftëse ekziston mëkat, organet kopetente si dhe personat kopetent janë mëkatarët dhe fajtorët më të mëdhenj.

RZK - Kumanovo ul. "Goce Delcev" br. 71/3 - Garnizon
ZANAET - ZEJA
ORZ - Kumanovë rru. "Goce Delcev" nr. 71/3 - Garnizon
tel/fax: ++389 (0) 31424 227 e-mail: natyra_likove@yahoo.com

**Oda rajonale zejtare Kumanovë**

Denacionalizim (jo)ligjor .

## Shtëpia e zejtarëve - pronësi që i ka kaluar Komunës

Në Republikën e Maqedonisë zhvillimi i sipërmarrjes d.m.th. ekonomsë së vogël dhe të mesme në të cilën llogaritet edhe kryerja e veprimtarisë zejtare, gjatë dy viteve të fundit, jo vetëm që ngeci, por u vu re një ulje e shpejtë në numurin e subjekteve që kryejnë veprimtari të caktuara dhe kjo gjatë gjithë vitit 2009. Kriza ekonomike botërore e cila nuk i la pas edhe vendet ballkanike, d.m.th dhe Maqedoninë, në mënyrë direktei preku dhe proceset zhvilluese të ekonomisë së dobët Maqedonase.Për këtë kontribut dha dhe qeveria ligjvënëse e cila në mënyrë të shpejtë solli disa ligje me qëllim përmbushjen e standarteve të vëna nga Bashkësia Europiane me qëllim fitimin sa më të shpejtë të një date për negociata dhe për të filluar procesin e pranimit në Familjen e madhe-EU. Këtu në veçanti do të theksojmë miratimin e "Ligjit për pagesat bruto/neto" i cili u bë pengesë e madhe për zhvillimin e ekonomisë në përgjithësi, si dhe pengesë e veçantë për zhvillimin e zejtarisë në R.e Maqedonisë. Jo më pak mëkat në drejtim të zhvillimit ekonomik të vendit, kanë politikat tatimore dhe të kreditimit; sistemi bankar; marraveshjet e parealizuara të politikës subvencionuese; mungesa e mjaftueshme e tregut.

Pavarësisht nga përpjekjet maksimale të Odës rajonale zejtare-Kumanovë, e cila i përfshin komunat: Kriva Pallankë, Kratovë, Rankovce, Staro Nagoriçane, Kumanovë dhe Lipkovë, e ndihmuar nga Oda zejtare-Koblenc nga Gjermania, numuri i zejtarëve gjatë vitit që kalon (2009) ka shënuar rënie të shpejtë. Nga 213 zejtarë të regjistruar në Odë, shifra ra në 38 zejtarë të cilët kërkuan ndërprerjen e ushtrimit të veprimtarisë zejtare.Gjatë dorëzimit të kërkesës për ndërprerjen e ushtrimit të zejtarisë si arsye përmenden tatimi i paligjshëm dhe fiskalizimi i zejtarëve nga Drjetoria e tatimeve publike me qendër në Shtip; gjobat maksimale të vëna nga inspektorët për mangësi të vogla pikërisht për kryesit e rregullt të veprimtarisë zejtare; konkurrenca e pandershme dhe mungesa e zbulimit të ushtruesve të paregjistruar të veprimtarisë zejtare.

Sipas sistemit njësportelsh të punës, Oda rajonale e Kumanovës anëtarëve të saj gjatë vitit të kaluar (2009) në mënyrë mjaft të kualifikuar i afroi shërbimet më të nevojshme, për të cilin kontribut të veçantë dhanë segmentet nga sistemi i institucioneve shtetërore kopetente në Maqedoni. Meritë të veçantë ka Regjistri Qendror-Zyra rajonale Kumanovë, veçanarisht me përgatitjen në kohë të dokumentacionit të nevojshëm për zejtarët, marrjen e vendimeve të shpejta për regjistrim të veprimtarisë zejtare, informimi në kohë i zejtarëve për funksionimin e dyqaneve individuale të zejtarëve. Veçanarisht theks të veçantë mund të vihet në një aspekt të rëndësishëm –Vetpunësimi si një segment integral i zhvillimit të ekonomisë së vogël dhe zejtarisë, dhe së bashku me atë të punësimit. Gjithsesi, çdo njeri së paku një herë në jetën e tij mendoi dhe ndërmorri idenë për të filluar një punë, për të verifikuar aftësinë e tij në biznes, ambicjet e veta, si rezultat i meritave të veta të realizojë rezultate të veçanta dhe të marrë fitim më të madh. Në të vërtetë, tek secili zejtar ose menaxher ngandonjëherë del idea të bëhet sipërmarrës, me të cilën do të nxjer në pah energjinë e brendshme dhe aftësinë, shkathtësinë dhe krijimtarinë e shpirtit të vet. Fillimi i aktiviteteve në biznesin e vogël dhe zejtarisë sjell me vete probleme të mëdha. Oda rajonale Kumanovë, e cila këtë vit është pranuar në Kancelarinë Ballkanike për zhvillim të ekonomisë së vogël dhe zejtarisë me qendër në Sofje ka shpallur tetë mjeshtër si zejtarë profesionalë, ka aprovuar të gjitha programet dhe normat e tjera të parashikuara për kualifikim dhe rikualifikim të zejtarëve, përgatit kuadro speciale për shfrytëzim të sistemit solar për ngrohje, si dhe në procedurë është formimi i seksioneve zejtare si dhe pjesmarrje e sukseshme në disa manifestime nacionale, ballkanike, dhe ndërkombëtare nëpërmjet së cilës bëhet e mundur prezantimi i zejtarëve nga Komuna e Kumanovës dhe afirmimi i zejtarisë maqedonase në përgjithësi.






## ODA RAJONALE E ZEJTARËVE MANASTIR



Tradita vazhdon

### "Zejtar "- Pasqyrë e zejtarisë

Oda rajonale e zejtarëve Manastir është e vendosur të luftojë për përmirësimin e pozitës së zejtarëve dhe zejtarisë. Si rezultat i këtyre qëllimeve, është arritur marraveshja për vazhdimin e botimit të gazetës "ZEJTAR"." ZEJTAR", e cila ka dalë me vendim të konferencës të zejtarëve të pavarur nga Manastiri, dhe filloi të botohet në qershor të vitit 1976. Të dhënat flasin se gazeta dilte çdo muaj deri në mars të vitit 1991. Sipas të dhënave të shpallura në numërin 125 në atë vit ishin regjistruar 1.645 zejtarë. Sot, numuri i zejtarëve është shumë herë më i vogël që do të thotë se nuk ka kushte për rritjen e tyre. Në të vërtet drejt saj synon Oda e zejtarëve, si dhe pushteti vendor. Mbi të gjitha, niveli i zhvillimit të zejtarisë flet për nivelin e zhvillimit të të gjithë ekonomisë si në Komunë ashtu edhe në Republikë. Vazhdimi i botimit të gazetës "ZEJTAR" është motivuar nga nevoja e informimit të gjithanshëm të zejtarëve për të gjitha problemet nga interesi i tyre dhe për të informuar organet lokale dhe shtetërore për problemet e zejtarëve dhe zejtarisë. Në fakt "Zejtar" ka për qëllim të jetë pasqyrë e interesave të të gjiithë subjekteve nga kjo sfere, si dhe prezantimin e tyre para publikut. Sepse, zejtarët gjithmonë kanë pasur dhe do të kenë ç`farë ti prezantojnë publikut. Pikërisht për këtë, Redaksia i fton në bashkëpunim të gjithë zejtarët, si nga Manastiri ashtu dhe nga rajoni. Tradita vazhdon, gjithsesi, në interes të përbashkët.

### Zejtaria në Komunën e Manastirit

***Transformimi ekonomiko-shoqëror u pasqyrua në pozitën e zejtarisë në shumë aspekte.**
***Vende ka shumë, të interesuar ka pak në procesin e tranzicionit.**

Numuri i dyqaneve zejtare është zvogëluar. Në mënyrë të dukshme transformimi ekonomiko-shoqëor u pasqyrua mbi veprimtaritë zejtare. Disa zanate humbën si rezultat i zhvillimit ekonomiko-shoqëror, ose si rezultat i ndryshimeve teknologjike, kurse të tjerët për shkak të ndryshimit të nevojave reale të qytetarëve, kjo për shkak të rënies së sistemit socialist, ekonomiko-shoqëror i cili përputhet dhe me pavarësinë e R.se Maqedonisë,

**Zejtaria - viktimë e tranzicionit,** mbasi filloi një proces i gjatë dhe pothuajse i pafund i të ashtëquajturit tranzicion, d.m.th. kalim nga një sistem në tjetër. Ndërmarrjet e mëdha, me përjashtim të disave në mënyrë të vetëdijëshme dhe iracionale, u shkatëruan në emër të "privatizimit "proces i cili edhe sot e kësaj dite nuk ka mbaruar. Një numër i konsiderueshëm i punonjësve mbetën pa punë, pa rrogë, të detyruar të jetojnë në kushte shumë të vështira. Me nxjerrjen e tyre në rrugë nuk u pakësuan as madhësia as nevojat e tyre, por u kufizuan në minimum kushtet për kënaqesinë e tyre. Ekonomia e vogël e cila ishte afruar si model alternativ i zhvillimit ekonomik nuk i dha rezultatet që priteshin, edhe për faktin që nuk përfshihej në ekonominë e madhe. Në këto kushte ç`farë e priste zejtarinë?

**Përshtatja në kushtet e reja të krijuara:**

Zejtarët , numuri i të cilëve ishte gjithmonë në rënie, ishin të detyruar ti përshtateshin kushteve të reja të krijuara, ose ti mbyllnin qepenët. Çarshija e vjetër filloi ta ndroj pamjen: shumë dyqane zejtare u shëndruan në dyqane tregëtare, kurse zanate të vecanta e ndërprenë funksionin e tyre.

### Aktivitete të Odës rajonale zejtare të Manastirit

Oda rajonale zejtare në Manastir është regjistruar në vitin 2004 në bazë të ligjit për kryerje të veprimtarisë zejtare. Oda funksionon në rajonin e komunës së Manastirit dhe Demir Hisarit. Që nga themelimi deri në vitin 2009 janë regjistruar gjithsej 314 zejtarë me veprimtari të ndryshme zejtare nga të cilat shumica janë parukierë, automekanik, autolarës, llamarinist, zdruktarë, qirixhinjë, argjendarë, këpucarë, kapelbërës, marangoz, rrobaqepës, bojaxhinj, xhampunues, muratorë, plastikpunues, elektriçistë, gurëgdhendës, furtar, zejtar për lojrat zbavitëse, biçikletar, fotograf, akulloreshitës, galanterë, punues fshesash e tj. Detyrë bazë e Odës është të mbrojë dhe të zhvillojë veprimtarinë profesionale dhe ligjore të zejtarëve. Krahas këtyre, Oda ekziston dhe për shkak të një zhvillimi kontuitiv të zejtarisë, ngritjen e kualitetit të shërbimeve të zejtarëve si dhe për përmbushjen e kërkesave optimale administrative, ekonomiko-financiare si dhe shërbimeve juridike, promovimin e zejtarisë si dhe rruajtjen e zanateve të vjetra dhe vënien e tyre në funksion të qëllimeve turistike të qytetit, nëpërmjet ruajtjes së traditave. Me fjalë të tjera mund të thuhet që Oda afron shërbimet e mëposhtme: informon, këshillon, afron shërbime, mbron të drejtat dhe obligimet, edukon, ngre probleme, ndërmerr iniciativa, krijon dhe promovon projekte politike për zhvillimin dhe promovimin e zejtarisë.

Si aktivitete më të mëdha gjatë vitit 2009 mund të përmendim: Mbi bazën e strukturës dhe Rregullores, organizimi dhe realizimi i provimit për mjeshtër i cili realizohet nga Ministria e arsimit dhe shkencës si dhe Rregullores së Odës rajonale të Manastirit, komisioni për provim shpalli 45 mjeshtërit e parë të Manastirit. Të gjithë zejtarët e interesuar kishin mundësinë në qoftëse plotësonin kushtet dhe kriteriumet për provim të pajiseshin me diplomën e mjeshtrit dhe të mermin pjesë dy herë në vit në këto provime të realizuara nga Oda rajonale. Këta zejtarë kishin privilegjin të ndodheshin midis mjeshtërve të parë të cilët realizuan trajnim profesional praktik të nxënësve. Diplomë e tillë për mjeshtër jepet me të njëjtin model siç është dhënë para 60 vjetësh.

Gjithashtu këtë vit u vendos rregulli i ri për përcaktimin e detyrimeve që duhen të paguajnë zejtarët. Me këtë mënyrë të re u rritën detyrimet që duhet të paguajnë zejtarë, përkatësisht PIO si dhe Fondi shëndetësor dhe kjo solli që të ketë reagim nga ana e zejtarëve. Për shkak të këtyre arsyeve Oda ndërmorri disa aktivitete dhe masa për uljen e detyrimeve në një nivel të arsyeshëm dhe në përputhje me të ardhurat reale të cilat i realizojnë zejtarët e Maqedonisë. Mbas këtyre aktiviteteve Oda arriti të përputh kërkesat e shtetit me kërkesat e zejtarëve.



Në bashkëpunim me Odën e Republikës, Oda rajonale Manastir dhe projekti Koblenc, zejtarët morrën pjesë në disa seminare dhe trajnime të ndryshme si: parukier, furtar, elektriçist si dhe punë artizanale shtëpie. Disa prej tyre u pajisën me çertifikatë. U realizua gjithashtu dhe trajnimi i administratës së Odës për realizimin e programit të ri për regjistrimin e zejtarëve.

Oda përpiloi plan për aktivitetet e zgjidhjes së problemeve të cilët duhen të paraqiten në rendin e ditës në Këshillin e Komunës së Manastirit për vitin 2010.

Në Komunën e Manastirit Oda përcolli dhe listën deficitare të zanateve të vjetra të cilat dalë ngadalë po shuhen me qëllim të njëjtat të lirohen nga tatimi personal si dhe nga tatime të tjera.

Në bashkëpunim me UNDP dhe zyrës së punësimit Manastir u përcaktuan zejtarë nga veprimtaritë deficitare ç`ka bëri të mundur që të liroheshin nga tatimi personal.

Oda rajonale ka përgatitur dhe projekte promovimi dhe edukative të zejtarëve dhe për realizimin e të njëjtave është në kërkim të donatorëve.

## PLANIFIKIMI I AKTIVITETEVE PËR VITIN 2010





Në 25 janar në Shtip dhe 26 janar në Shkup këtë vit, përgjegjësit e projektit për Partneritet të Odës së zejtarëve Koblenc do të organizojnë repart pune në kuadër të procesit për planifikim të projekteve për vitin 2010.

Koordinimi i aktiviteteve do të kryhet nën udhëheqjen e të dy partnerëve, Odës së zejtarve të R.së Maqedonisë dhe Odës së zejtarëve Shkup.

Prioritetet e projektit të partneritetit edhe kët vit janë rritja e kapacitetit të Odave zejtare, promovim dhe afirmim të zejtarisë, implementim të Ligjit për arsim profesional dhe trajnim. Mbi bazën e bisedimeve dhe diskutimeve me partnerët do të hartohet programi vjetor i cili do të shpallet në faqen tonë të internetit.



Mbas pajisjes me Diplomë për shkollat e mesme me afinitete dhe dije, përfshirje direkte në procesin e punës!

## Projekt pilot për realizimin e trajnimit praktik të nxënësve tek mjeshtërit zejtarë

Shkolla e mesme profesionale dhe kualifikimi gjithmonë kanë qenë pikat e gravitacionit në projektin e partneritetit të Odës së zejtarëve Koblenc dhe Odës së zejtarëve të R. së Maqedonisë e mbështetur nga ministria e bashkëpunimit dhe e zhvillimit të R. së Gjermanisë. Bëhet fjalë për projekt i cili që nga viti 2000 e nxit dhe e mbështet zejtarinë maqedonase në përpjekjet e saj për të krijuar kushte të përshtatshme për zejtarinë si dhe formimin e Odave të zejtarisë si një sistem i plotë në R. e Maqedonisë. Trajnim dhe verifikim i aftësisë profesionale për zanatet e zejtarisë, trajnim dhe dhënia e provimit për mjeshtër si dhe pjesmarrje të mjeshtërve në provimet përmbyllëse pikërisht tek pjesa praktike në shkollat e mesme profesionale janë kopetenca publike të cilat Odave zejtare i kanë kaluar në bazë të Ligjit për kryerjen e veprimtarisë zejtare në R.M. Ligj i miratuar në shtator të vitit 2004. Me qëllim të rinjtë në mënyrë direkte të përfshihen në procesin e punës nga fusha të ndryshme ose degë të ekonomisë, ata duhet të aftësohen si kuadro të kualifikuar me kopetenca dhe aftësi të fituara më parë dhe jo të njëjtat ti fitojnë mbas punësimit të cilat janë problem për vet të rinjtë.Punëdhënësit hasin në një realitet , të rinjëve të punësuar që janë jo plotësisht kopetentë dhe të aftë ti paguajnë rrogë, të ardhura si dhe taksë të ndryshme dhe në të njëjtën kohë ti mundësojnë atyre trajnime me qëllim kompletimin e kopetencave dhe aftësive për kryerjen e detyrave dhe të punës. Përvojat e shumë vendeve në botë veçanarisht në Gjermani treguan se ky problem mund të tejkalohet vetëm me një arsim profesional, praktik, modern dhe të orienteuar, që në fakt është dhe një bindje mbi bazën e së cilës mbështeten dispozitat e Ligjit për arsimin profesional në R.M. i aprovuar në qershor të 2006. Dëshirë për kontribut në implementimin e Ligjit për arsimin e mesëm profesional si dhe trajnim në R.M. shprehën Ministria e arsimit, Qendra për arsimin e mesëm profesional dhe trajnim të R.M.,"Ost-West GmbH Koblenc"-zyrë projektuese e Odës së zejtarëve Koblenc në Shkup, Oda zejtare Shkup, shkolla e mesme profesionale e qytetit të Shkupit "Dimitar Vllahov" për zanatet parukierë dhe kozmetikë, Oda rajonale e zejtarëve si dhe shkolla e mesme teknike "Nace Bugjoni"për aftësim elektronik. Për realizim të shpejtë dhe të suksesshëm si dhe për përmbushje të dëshirave të tyre partnerët në qershor të 2009 nënshkruan "Memorandum për realizimin e projektit pilot në lidhje me implementimin e Ligjit për shkollat e mesme profesionale dhe trajnimin në R.M." për vitin mësimor 2009/2010. Në hotel Kontinental në 5 nëntor të vitit 2009 u realizua hapja solemne e fillimit të projektit Pilot për realizimin e trajnimit praktik te nxënësve tek mjeshëtrit zejtarë. Me këtë projekt të financuar në kuadër të projektit Partneritet të Odës së zejtarëve Koblenc udhëheq ekip i përbërë nga përfaqësues të të gjithë partnerëve dhe ka për detyrë ti përcaktojë detyrat e Odave të zejtarëve të cilat i përpilojnë marrëveshjet trepalëshe për trajnm profesional midis punëdhënësit, nxënësit, ( për ata nënshkruan prindi) dhe shkollës, ndjek nënshkrimin e tyre si dhe i regjistron në regjistrin e nxënësve për trajnim profesional, si dhe ndjek të gjithë procesin e trajnimit të nxënësve në punishtet zejtare me qëllim përfitimin e kopetencave dhe aftësive për tu përfshire direkt në procesin e punës. Në ekip janë përfshirë dhe përfaqësues të Ministrisë së ekonomisë, Ministrsë së punës, Qytetit të Skkupit si dhe Odës së zejtarëve të R.M. për arsye të ndikimit të madh të këtij projekti në ekonominë e përgjithshme të Maqedonisë. Si udhëheqës i ekipit me propozim të Odës së zejtarëve Koblenc, emërohet person kopetent nga Gjermania kjo duke pasur parasysh faktin e një përvoje të pasur gjermane në fushën e arsimit tek i cili konvergjon Ligji maqedonas për arsim profesional të mesëm dhe trajnim. Në kuadër të projektit shtrohet si detyrë të verifikohet gadishmëria teknike dhe e kuadrit për implementimin e Ligjit për arsimin e mesëm profesional dhe trajnim, si dhe sa janë të përgatitur mjeshtërit e zejtarisë të pranojnë nxënës për trajnim praktik. Mbas mbarimit të pilot projektit kryhet analizë se sa nxënës të cilat trajnimin praktik e realizuan tek mjeshtërit u pajisën me aftësi dhe ide në krahasim me nxënësit të cilat një trajnim të tillë e kryen në qendrat e shkollave. Propozimet do të paraqiten tek Ministria e arsimit dhe Qendës për arsim profesional dhe trajnim me qëllim të reformohen planet mësimore për arsimimin trevjecar për nevojat e zejtarisë dhe ekonomisë në R.M. dhe në të do parashikohet një trajnim i cili përfshin 50% të të gjithë procesit mësimor dhe ky trajnim do të realizohet tek zejtarët të cilët kanë dhënë provimin e mjeshtrit, në këtë mënyrë do të sigurohen kuadro të rinj dhe kopetentë të cilat pa vështirësi menjëherë pas diplomimit në shkollën e mesme profesionale në mënyrë kopetente do të përfshihen në procesin prodhues.



| Data | LISTA E PANAIREVE PËR VITIN 2010 | Vendi i panairit |
|---|---|---|
| 30.01.-01.02.2010 | Beautworld-Panair ndërkombëtar në Frankfurt Panair ndërkombëtar për tregeti i dedikuar për parfimeri, kozmetikë, farmaceutikë, dhe parukierë. | Frankfurt në Majna, Gjermani |
| 31.01.-03.02.2010 | ProSweets Cologne-Panair ndërkombëtar për furnizues të ëmbëlsirave. | Keln, Gjermani |
| 06.02.-10.02.2010 | INTERGASTRA-Panair ndërkombëtar për hotelieri, gastronomi, ketering, kafiteri e tj. | Shtutgard në Majna, Gjermani |
| 12.02.-16.02.2010 | Ambiente-Panair ndërkombëtar në Frankfurt | Frankfurt në Majna, Gjermani |
| 19.02.-22.02.2010 | Inhorgenta europe-Panair ndërkombëtar për orë Bizhuteri, gurë të çmuar, perlë dhe teknologji. | Minhen, Gjermani |
| 03.03.-09.03.2010 | Panair ndërkombëtar për zejtarë. | Minhen, Gjermani |
| 12.03.-17.03.2010 | INTERNORGA-Panair ndërkombëtar për hotelieri, Gastronomi, ketering, furtar e tj. | Hamburg, Gjermani |
| 24.03.-27.03.2010 | Fensterbau/frontale+HOLZ-HANDWERK-Panair Ndërkombëtar për dritare, dyer, fasadë, dhe panair europian për teknologjinë mekanike si dhe kërkesave për prodhim. | Nirnberg, Gjermani |
| 26.03.-28.03.2010 | BEAUTY INTERNATIONAL DUSSELDORF- Panairi më I mirë për profesionistë në kozmetikë, manikir dhe pedikir. | Dizeldorf, Gjermani |
| 27.03.-29.03.2010 | TOP HAIR INTERNATIONAL-Panair për trendet dhe Moden-Show-kongres ndërkombëtar në fushën e parukerisë. | Dizeldorf, Gjermani |
| 10.04.-18.04.2010 | AMI-AUTO MOBIL INTERNATIONAL co AMITEC Panair për pjesë të makinave, shërbime dhe servise, AMIKOM, - Panair për teknologji zbavitese, komunikative, të automobilave si dhe navigacion. | Lajpcig, Gjermani |
| 14.04.-17.04.2010 | IFH/INTHERM-Panair për ngrofjen, kondicionimin, energjitë riprodhuese si dhe sanitare. | Nirnberg, Gjermani |
| 19.04.-25.04.2010 | Bauma-Panair ndërkombëtar për makineritë e ndërtimit, makineritë për prodhimin e materialeve të ndërtimit, makineri për minierat, makineri për prodhimin e automjeteve që përdoren në ndërtim si dhe pajisjeve ndërtimore. | Minhen, Gjermani |
| 21.04.-23.04.2010 | RESALE-Panair botëror për makineri të përdorura, dhe pajisjet e tyre. | Karlsrue, Gjermani |

## Republika e Maqedonisë ka potencial diellor me mbi 260 ditë gjatë vitit

Është koha që Maqedonia të përfshihet në trendin botëror i cili ka linja progresive të zhvillimit, trend në të cilin akcenti është vënë pikërisht tek ambienti jetësor, më konkretisht shfrytëzimi i energjisë ripërtëritëse.Maqedonia pikërisht në këtë fushë është mjaft e dobishme për zejtarinë, firmat e mëdha dhe të mesme bëhen gjithnjë e më aktivë falë Projektit për bashkëpunim ekonomik midis landit (krahinës) Rajnland-Pfalc nga Gjermania dhe vendeve të Europës Juglindore dhe kjo në një bashkëpunim të vazhdueshëm me zyrën e ballkanit për zejtari dhe ekonomi të vogël. Në kuadër të këtij projekti është parashikuar trajnim me qëllim të krijohet kuadër fillestar për instalim, i cili më tej do të tranojë persona të tjerë. Ky kuadër krahas montimit do të jetë njëkohësisht i ngarkuar për kontrollimin dhe mirmbajtjen e sistemeve solare.

Trajnimi përbëhet nga dy module teorike me kohëzgjatje prej 5 ditësh dhe një ditë praktikë e cila do të realizohet në Gjermani në shkurt të vitit 2010. Moduli i parë teorik u udhëhoq nga ekspert gjerman dhe u realizua nga 16-20.11.2009 me temë bazat e elektroteknikës dhe të rrezeve ultravioletë. Përzgjellja e pjesmarrësve është bërë nga ana e Odës së zejtarëve të Republikës së Maqedonisë, Odës së Shkupit si dhe Odave rajonale të Shtipit dhe të Kumanovës, të gjithë antarë të Odës Ballkanike për zhvillim të zejtarisë dhe ekonomisë së vogël.



Moduli i dytë teorik me temë bazat e teknikës solare është i parashikuar nga 25.-29.janar 2009 në Maqedoni.

Trajnimi do të përmbyllet me modul praktik i cili do të realizohet në Gjermani nga 08.-12.shkurt 2010. Mbas realizimit të modulit të parë u vu re krenari të kursantëve të cilët do të jenë kuadrot e parë të kualifikuar në Maqedoni për këtë punë.Të gjithë pajtohen me faktin se profesorë dhe inxhinierë nga kjo fushë ka shumë, por kur bëhet fjalë për realizim praktik të punëve përkatësisht montimin e paneleve solare në çati, nuk ka asnjeri.

Kursantët pas realizimit me sukses të të gjitha moduleve si dhe praktikës paisen me Çertifikatë për instalimin e energjisë solare.

Ky trajnim i cili është i finansuar nga qeveria gjermane është një pjesë e projektit për bashkëpunim ekonomik midis COE dhe Rajnland-Pfalc dhe në qoftëse paraqitet interes në të ardhmen mund të realizohen trajnime të tilla për biomasën dhe gjeoterminë dhe në këtë mënyrë Maqedonia kap hapin me trendet e botës.






NET-BAJ DOO, +38923216422, faks: +38923216469
ul. Dame Gruev 2, 1000 Skopje, R. Makedonija

e-mail: info@net-bay.com.mk
www.net-bay.com.mk




**MAKOHEMIK dooel uvoz-izvoz**

TRGOVIJA SO PRIBOR, BOI I LAKOVI

Prvomajska bb-Pintija, 1000 Skopje, Makedonija
e-mail: makohemik@yahoo.com

**ADMINISTRATIVNO-DELOVEN OBJEKT-PINTIJA**
☎ +389(0)2 2728 791; +389(0)2 2728 790; tel./fax +389(0)2 2728 789

**PORTA VLAE** ☎ 02/2043 320 < **PRODAVNICA** > **DRACEVO** ☎ 02/2795 121

**KISELA VODA** ☎ 02/3213 314; 02/3136 236







**FOOD CONSULTING**
Имплементација на HACCP, HALAL, GLOBALGAP, ISO 9001, 22000, 14001
Подготовка на апликации за ИПАРД

"ПОЗИТИВА"
економско правно биро

- книговодствени услуги
- регулирање на стаж
- работни односи
- пензиски права
- пренос на имот

Ристовски Ване

тел.: +389 (0)2 31 33 144
факс: +389 (0)2 31 13 677



РЕГИОНАЛНА ЗАНАЕТЧИСКА КОМОРА
ШТИП